



31 MARS 2015

BASHKËSIA/ASOCIACIONI I KOMUNAVE ME SHUMICË SERBE: NJË KLUB EKSKLUZIV I BAZUAR NË PËRKATËSINË ETNIKE?

Adrian Zeqiri & Pieter Troch

Hyrje

Që nga koha kur ishte sjellë në Marrëveshjen e parë për normalizimin e marrëdhënieve ndërmjet qeverive të Kosovës dhe Serbisë, të nënshkruar nëpërmjet një procesi të lehtësuar nga Bashkimi Evropian më 19 prill 2013, Asociacioni/Bashkësia e komunave me shumicë serbe (në tekstin e mëtejshëm: Asociacioni) është bërë një temë në modë në politikën e Kosovës dhe ka marrë vendin qendror në negociatat politike në mes të Qeverisë së Kosovës në njërin anë dhe të Serbisë dhe politikanëve serbë të Kosovës në anën tjetër. Asociacioni është bërë një mollë shërri në marrëdhëniet e përkeqësuar politike brenda Qeverisë të Kosovës në mes të partive shqiptare në koalicion dhe listës Srpska, që është nën kontrollin e drejtpërdrejtë të Qeverisë së Serbisë. Qeveria serbe dhe përfaqësuesit politik të serbëve të Kosovës kanë bërë të qartë që lista Srpska nuk do të kthehet në qeverinë e Kosovës deri në përmbushjen e kushteve të marrëveshjes së koalicionit të arritur me partitë shqiptare në Qeverinë e Kosovës, duke përfshirë edhe krijimin e Asociacionit.¹

Qeveria e Kosovës, në anën tjetër, ka argumentuar se kjo do të ishte e paarsyeshme nga ana e tyre për të shkuar përpara me bisedimet e mëtejshme në Bruksel – lexo: diskutime të mëtejshme mbi Asociacionin – për sa kohë që Serbia nuk angazhohet plotësisht për zbatimin e marrëveshjeve që janë arritur tashmë, veçanërisht në integrimin e gjyqësorit në veri të Kosovës, shthurjen e institucioneve paralele serbe, duke përfshirë mbrojtjen civile dhe integrimin e tyre në institucionet e Kosovës, si dhe lirinë e lëvizjes, duke përfshirë heqjen e të gjitha barrikadave.² Të gjitha partitë shqiptare në Kosovë, si ato në qeveri ashtu edhe ato në opozitë, ndajnë qëndrimin për të mos lejuar që Asociacioni të dëmtojë rendin kushtetues të Kosovës dhe për të mos lejuar që Asociacioni të bëhet një subjekt i pakontrollueshëm që do të bllokonte shtetin dhe shoqërinë e Kosovës në vitet në vazhdim, siç është rasti me situatën në Bosnje-Hercegovinë me Republikën Serbe.

Debatet që rrethojnë krijimin e Asociacionit dhe zbatimin e Marrëveshjeve të Brukselit që kanë të bëjnë me integrimin e komunitetit serb në Kosovë, në përgjithësi janë duke dërguar në një bllokim gjithnjë e më shqetësues politikë të strukturuar në linja fikse etnike shqiptaro-serbe. Ky raport, që është i dyti në një seri raportesh që kërkojnë të kontribuojnë në përmbajtjen e diskutimit për Asociacionin, në përputhje me misionin dhe traditën e ECMI Kosovës për të trajtuar tema që kanë të bëjnë me çështje të ndërlikuara etnike në Kosovë gjatë gjithë këtyre

¹ <http://koha.net/?id=27&l=50896>.

² Qeveria e Kosovës, 'Gjendja në zbatimin e marrëveshjeve të Brukselit' (23 mars, 2015), faqe 15–16.

viteve, paralajmëron kundër të kuptuarit kaq të ngushtë të shoqërisë kosovare, në vetëm shqiptarë dhe serbë dhe në mënyrë kritike vlerëson të kuptuarit e Asociacionit në baza etnike.

Një klub ekskluziv i bazuar në përkatësinë etnike?

Asociacioni është parashikuar të përfshijë gjashtë komunat me shumicë serbe që janë krijuar nëpërmjet procesit të decentralizimit (Novobërda, Mitrovica Veriore, Graçanica, Ranillugu, Partesh, dhe Kllokoti)³ përveç katër komunave me shumicë serbe që ekzistojnë më parë: Shtërpca, Zveçani, Leposaviqi dhe Zubin Potoku. Sipas Marrëveshjes së Parë (neni 1), anëtarësimi në Asociacion do të jetë i hapur për çdo komunë tjetër me kusht që komunat pjesëmarrëse janë të pajtimit për një anëtarësim të tillë. Kufizimi se Asociacioni do të jetë i hapur për komunat e tjera vetëm me mbështetjen unanime të komunave pjesëmarrëse nënkupton se anëtarësimi në klub do të mbetet ekskluziv dhe nuk shihen gjasa që ndonjëherë të përfshijë komunat me shumicë shqiptare. Në mënyrë indikative, politikanët serbë kanë propaganduar në mënyrë të përsëritur krijimin e komunave të reja të Gorës dhe Prilluzhës dhe përfshirjen e tyre të mëvonshme si anëtarë të Asociacionit.⁴ Komuna e Gorës do të përbëhej nga pjesa jugore e komunës së tanishme të Dragashit, e cila është kryesisht e banuar me popullsi gorane dhe boshnjake. Komuna e Prilluzhës do të përbëhej nga fshatrat kryesisht të banuara me serbë të Prilluzhës dhe Gracës në komunën e Vushtrrisë dhe fshatrat Plemetinë, Babimoc dhe Caravadicë në komunën e Obiliqit.

Krijimi i komunave të reja është i mundur në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës. Ligji për kufijtë administrativë të komunave thekson se "krijimi i komunave të reja, bashkimi, ndarja, ndryshimi i kufijve administrativ të komunës dhe caktimi i emrit apo selisë së komunës bëhet me plotësimin dhe ndryshimin e këtij ligji", por se "kufijtë administrativ të komunës nuk mund të ndryshohen pa një konsultim paraprak me qytetarët e komunave ose pjesët/fshatrat e komunave të prekura nga ndryshimi".⁵ Është përmendur veçanërisht se "Qeveria do të hyjë në konsultime me komunitetet jo-shumicë në rastet kur ky komunitet përbën së paku 75% të popullsisë të përqendruar në një vendbanim në një apo më shumë zona kadastrale me një popullsi të gjithëmbarshme prej së paku 5000 qytetarëve, me qëllim të krijimit të komunave të reja".⁶ Qeveria e Kosovës nuk i ka shprehur zyrtarisht pëlqimin e saj asnjërës prej komunave të reja dhe propozimi nuk duket të jetë me prioritet të lartë për palën serbe në këtë fazë, kështu ka të ngjarë që anëtarë "themelues" të Asociacionit të komunave me shumicë serbe, siç nënkuptohet me vetë emrin e Asociacionit, do të jenë dhjetë komunat e lartpërmendura me shumicë serbe në Kosovë.

Megjithatë, një kuptim i tillë i ngushtë etnik i Asociacionit si një mekanizëm për mbrojtjen, në mënyrë ekskluzive, e popullatës serbe në Kosovë është në kundërshtim me frymën kundërdiskriminuese të ligjit të Kosovës dhe të të kuptuarit shumë-etnik të Kosovës, e cila shkon përtej ndarjes së ngushtë, në vetëm shqiptarë dhe serbë, që aktualisht është duke dominuar debatin politik dhe të menduarit në lidhje me Asociacionin. Prandaj, emërtimi serb ndoshta do të duhet të hiqet nga emërtimi përfundimtar i Asociacionit. Për të gjitha qëllimet dhe synimet, arsyetimi në mbështetje të krijimit të Asociacionit do të duhet të rishqyrtohet. Faktori i thjeshtë etnik, që është përmendur në Marrëveshjen e Parë, nuk është vetë-shpjegues dhe i mjaftueshëm për të justifikuar bashkëpunimin komunal. Krijimi i Asociacionit të komunave me shumicë serbe duhet të justifikohet duke u fokusuar në atë se si bashkëpunimi komunal do të lejojë komunat në fjalë për të kryer më mirë funksionet e tyre, në përputhje me parimet kushtetuese të vetëqeverisjes

³ [Ligji për kufijtë administrativë të komunave](#) (20 shkurt, 2008), Neni 5.

⁴ http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2014&mm=11&dd=10&nav_id=922041

⁵ [Ligji për kufijtë administrativë të komunave](#) (20 shkurt, 2008), Neni 9.

⁶ [Ligji për kufijtë administrativë të komunave](#) (20 shkurt, 2008), Neni 12.

lokale: "të qeverisjes së mirë, transparencës dhe efikasitetit në ofrimin e shërbimeve publike".⁷ Ligji për bashkëpunim ndërkomunal thekson se bashkëpunimi ndërkomunal duhet të bazohet në interesin reciprok, punën e përbashkët të një apo më shumë kompetencave komunale, vullnetin e lirë të komunave, ndarjen e roleve dhe përgjegjësi dhe bashkimin e burimeve komunale, si dhe në përmirësimin e ekonomisë dhe efikasitetin e shërbimeve komunale në emër të qytetarëve.⁸

Në lidhje me arsimin, kujdesin shëndetësor, dhe çështjet kulturore,⁹ bashkëpunimi komunal në mes të komunave me shumicë serbe do të përmirësojë ofrimin e shërbimeve për qytetarët, sepse këto janë kompetenca që janë të lidhura ngushtë me gjuhën, kulturën dhe historinë e komunitetit serb të Kosovës. Sa i përket planifikimit urban dhe rural dhe zhvillimit ekonomik, kompetencat e tjera të përmendura në Marrëveshjen e Parë, arsyetimi është më pak evident, pasi këto janë fusha që nuk janë të lidhura drejtpërsëdrejti me identitetin kombëtar por më tepër në faktorë gjeografikë në nivel rajonal dhe lokal, ndërsa komunat me shumicë serbe nuk janë gjeografikisht të lidhura.¹⁰ Me fjalë të tjera, do të jetë e vështirë për të arsyetuar pse komuna e Shtërpçës do të bashkëpunojë për sa i përket zhvillimit ekonomik apo planifikimin rural dhe urban me Komunën e Zveçanit, në vend se me Komunën e Ferizajt apo të Prizrenit.

Të kuptuarit e Asociacionit mbi bazë etnike gjithashtu sfidon karakterin shumetnik të komunave të Kosovës. Kushtetuta e Republikës së Kosovës thekson se vetëqeverisja lokale duhet të ketë "kujdes të posaçëm për nevojat dhe interesat specifike të komuniteteve që nuk janë shumicë dhe pjesëtarëve të tyre".¹¹ Në të gjitha dhjetë komunat me shumicë serbe jetojnë komunitetet pakicë jo-serbe, në disa raste në numër të konsiderueshëm, marrë parasysh që shqiptarët jetojnë në të gjitha dhjetë komunat e në veçanti në Novobërdë, Shtërpçë, Mitrovicë të Veriut, Kllokot dhe Graçanicë, romët jetojnë në Graçanicë, Novobërdë dhe në veri të Kosovës, ndërsa goranët dhe boshnjakët jetojnë në Mitrovicë të Veriut. Një numër i masave afirmative mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e këtyre komuniteteve jo-shumicë në nivel komunal, përfshirë përfaqësimin në organet komunale, të drejtën e përdorimit të gjuhës së tyre, të drejtën e shkollimit në gjuhën e tyre, e të tjera. Veçanërisht të rëndësishme në kuadër të organeve komunale janë:

- Komiteti për komunitete përfshin përfaqësues të të gjitha komuniteteve që jetojnë në komunën përkatëse dhe këshilltarët e Kuvendit të Komunës. Këta të parët formojnë shumicën në Komitetin për komunitete. Komiteti është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, praktikave dhe aktiviteteve komunale dhe për t'i bërë rekomandime Kuvendit të Komunës me qëllim të promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave të të gjitha komuniteteve në komunën përkatëse.¹²
- Në komunat ku së paku 10% e qytetarëve i përkasin komuniteteve jo shumicë në komunë, një emërohen Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit Komunal për Komunitete dhe Zëvendës Kryetari i Komunës për Komunitete.
 - Pozita e Zëvendës-kryesuesit të Kuvendit Komunal për Komunitete rezervohet për kandidatin e komunitetit jo-shumicë, që ka marrë shumicën e votave në zgjedhjet

⁷ [Kushtetuta e Republikës së Kosovës](#), Neni 123.4.

⁸ [Ligji për bashkëpunimin ndër-komunal](#) (21 korrik, 2011), Neni 5.

⁹ Këto të fundit janë jashtëzakonisht pak të përmendura në listën e fushave në të cilat Asociacioni do të ketë vështrim të plotë në bazë të Marrëveshjes së Parë (Neni. 4), edhe pse kjo është një kompetencë e zgjeruar e të gjitha komunave me shumicë serbe dhe do të mund të përfitojnë shumë nga bashkëpunimi ndër-komunal. Shih [Ligjin për vetëqeverisje lokale](#) (20 shkurt, 2008), Neni. 19.3.

¹⁰ Grupi ballkanik për hulumtimin e politikave, "Integrimi i serbëve në Kosovë pas Marrëveshjes së Brukselit", raport i pabotuar i politik (19 mars, 2015), faqe 35.

¹¹ [Kushtetuta e Republikës së Kosovës](#), Neni 123.4.

¹² [Ligji për vetëqeverisje lokale](#) (20 shkurt, 2008), Neni 53.

- komunale. Zëvendës Kryesuesi i Kuvendit për Komunitete promovon dialogun ndërmjet komuniteteve dhe shërben si pikë zyrtare e kontaktit për adresimin e brengave dhe interesave të komuniteteve jo-shumicë në Kuvendin Komunal.¹³
- Zëvendës Kryetari për Komunitete emërohet me propozimin e kryetarit të komunës dhe me miratimin e Kuvendit Komunal. Nënkryetari për komunitete i ndihmon kryetarit dhe jep udhëzime për çështjet që lidhen me komunitetet jo-shumicë.¹⁴

Krijimi i çdo lloj institucioni mbi baza etnike dhe nga sa thuhet përjashtimi i komuniteteve të tjera është në kundërshtim me parimet shumetnike të Kushtetutës dhe kuadrit ligjor të Kosovës, duke përfshirë edhe masat afirmative për përfaqësimin e pakicave në nivelin komunal. Duhet të përdoret një formulim dhe arsyetim tjetër në debatet mbi Asociacionin dhe në Statutin përfundimtar të tij nëse Asociacioni do të reflektonte këtë frymë.

Për më shumë informata ju lutem na kontaktoni në + 381 (0) 38 224 473 ose përmes postës elektronike në info@ecmikosovo.org

¹³ [Ligji për vetëqeverisje lokale](#) (20 shkurt, 2008), Nenet 54 – 55.

¹⁴ [Ligji për vetëqeverisje lokale](#) (20 shkurt, 2008), Neni 61.

Raporte dhe analiza të tjera politike:

[Komunitetet pakicë jo-serbe të neglizhuar në marrëveshjet teknike në mes të Kosovës dhe Serbisë](#)

10 mars, 2015

[Deklarata e diskutueshme e ministrit Murati dhe reagimet që pasuan](#)

5 mars, 2015

[Asociacioni/Komuniteti i komunave me shumicë serbe: Shumë spekulime, pak marrëveshje faktike dhe mos-zbatim](#)

22 shkurt, 2015

[Një sistem i unifikuar juridik dhe gjyqësor në Kosovë?](#)

15 shkurt, 2015

[Çfarë duhet të mbahet mend nga rasti Jablanović?](#)

8 shkurt, 2015

[Thirrje për Arsye dhe Veprim pas protestave në Prishtinë](#)

25 janar, 2015

[Farkimi i një ambienti të punës në kuadër të Qeverisë së Kosovës](#)

19 janar, 2015

[ECMI Kosova dënon bllokadën e dhunshme të hyrjes në Kishën Ortodokse Serbe në Gjakovë](#)

7 janar, 2015

[Formimi i Qeverisë së re të Kosovës, Përfaqësimi i komuniteteve pakicë dhe Sfidat që dalin përpara](#)

10 dhjetor, 2014

[Një vështrim mbi situatën e fundit të sigurisë në Kosovë](#)

4 nëntor, 2014

[Komunitetet pakicë dëshirojnë të shohin fundin e ngërçit politik](#)

23 tetor, 2014

[Partitë politike të minoriteteve në mjedisin politik në ndryshim e sipër në Kosovë](#)

31 korrik, 2014

[ECMI Kosova bën thirrje për qetësi pas përshkallëzimit të tensioneve etnike pas ndeshjes kualifikuese në futboll midis kombëtareve të Serbisë dhe Shqipërisë](#)

15 tetor, 2014

[Ndërlidhja e ndarjes: Krijimi i një Bordi të Përbashkët për qytetin e Mitrovicë](#)

27 qershor, 2014

[Zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë: Një Shikim i Çështjeve, sfidave dhe skenës politike në prag të zgjedhjeve të 8 qershorit](#)

2 qershor, 2014

Rreth ECMI Kosovës

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të komuniteteve minoritare në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumetnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, dhe përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin dhe bashkëpunuar në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.